



---

**VENDIM**

*Nr. 129, Datë 06.12.2011*

**PËR  
CAKTIMIN E EKSPERTIT QE DO TE PERFAQESOJ ERE-N NE  
PANELIN RISHIKUES TE KERKUAR NGA CEZ SHPERNDARJE SH.A,**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 10126 datë 11.05.2009, “Për Miratimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 06.12.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shpërndarje me shkresën nr. 6571, Prot., date 23.11.2011 për ngritjen e Panelit Rishikues për vendimet e ERE-s që lidhen me miratimin e tarifave të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike si dhe informacionet e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

**Vendosi:**

1. Të caktojë KPMG në cilësinë e ekspertit që do të përfaqësoj ERE-n ne Panelin rishikues te kërkuar nga CEZ Shpërndarje sh.a, lidhur me vendimet e ERE-s që lidhen me miratimin e tarifave të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë CEZ Shpenrdarje sh.a, dhe METE për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.